



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 gusht 2015
Nr. ref.: RK 836/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI18/15

Parashtrues

**“Iming” D.O.O.
pronar Rrustem Zogaj**

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0357-A0001, të 5 shkurtit 2015

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është kompania “Iming” D.O.O., me seli në Stobec të Republikës së Kroacisë, pronar i të cilës është z. Rrustem Zogaj. Parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga z. Sahit Bibaj dhe z. Gafurr Elshani, avokatë në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJS), AC-I-14-0357-A0001, i 5 shkurtit 2015, me të cilin vërtetohet Aktvendimi i Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar i DHPGJS), C-I-14-0022, i 19 nëntorit 2014 për refuzimin e propozimit të parashtruesit për nxjerrjen e urdhrit paraprak gjyqësor.
3. Aktvendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 9 shkurt 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të lartpërmendur të Kolegjit të Apelit të DHPGJS, me të cilin ankesa e parashtruesit kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së ishte refuzuar si e pabazuar.
5. Kolegji i Specializuar i DHPGJS, kishte refuzuar propozimin e parashtruesit për nxjerrjen e urdhrit paraprak gjyqësor, nëpërmjet të cilit parashtruesi kishte kërkuar pezullimin e përkohshëm të vendimeve të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për tërheqjen e aksioneve dhe vendosjen e Ndërmarrjes së Re MIM "Golesh" nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP).
6. Parashtruesi gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) që të vendosë Masë të përkohshme, përkatësisht *"NDALIM TE EKZEKUTIMIT TE VENDIMEVE TE AKP-së, me nr. Ref. BD-69/35, të dt. 31 gusht 2014, Vendimi Bd-69/36, i po të njëjtës datë, si dhe aktvendimet e Kolegjit të Specializuar te Dhomës së Veçantë te Gjykatës Supreme te Kosovës, C-I-14-0022, i dt. 19.11.2014 dhe aktvendimit te Kolegjit te ankesave të njëjtës Dhomë, me nr. AC-I-14-0357-A0001, i dt. 05.02.2015, deri në vendosje definitive nga Gjykata"*.

Baza juridike

7. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 si dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

8. Më 19 shkurt 2015, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).

9. Më 12 mars 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI18/15, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI18/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
10. Më 30 mars 2015, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës DHPGJS dhe AKP-së.
11. Më 26 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI18/15 për zëvendësimin e gjyqtarit raportues të këtij rasti caktoi Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja, me Vendimin KSH. KI18/15, në vend të Enver Hasanit, të cilit i ka përfunduar mandati i gjyqtarit të Gjykatës më 26 qershor 2015, caktoi Arta Rama-Hajrizin anëtare në Kolegjin shqyrtues.
12. Më 2 korrik 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 11 dhjetor 2007, pas përfundimit të procesit të privatizimit nëpërmjet procedurës së Spin-Off-it special, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejshëm: AKM-ja), lidhi kontratë me parashtruesin e kërkesës për t'i shitur këtij tërë kapitalin aksionar të Ndërmarrjes së Re MIM "Golesh" SHPK (në tekstin e mëtejshëm: MIM "Golesh").
14. Kontrata e lidhur në mes të AKM-së dhe parashtruesit të kërkesës, detyronte parashtruesin që të përmbushë disa kushte të caktuara, të parapara në marrëveshjen e zotimeve. Në mesin e atyre kushteve, ishin zotimet për të realizuar investime të caktuara financiare, dhe punësimin e një numri të caktuar të punëtorëve brenda një afati të caktuar kohor. Mospërmbushja e këtyre obligimeve mund të rezultonte në tërheqjen e aksioneve.
15. Sipas shkresave të lëndës del se AKP-ja, si pasardhëse ligjore e AKM-së, gjatë vitit 2009, për arsye të mospërmbushjes së zotimeve të përcaktuara në Marrëveshjen e zotimeve brenda kohës së caktuar, kishte caktuar një zgjatje të afatit për 2 (dy) vjet, afat që kishte përfunduar në vitin 2011.
16. Në vitin 2012, Bordi i Drejtorëve të AKP-së me arsyetimin e mospërmbushjes së zotimeve nga ana e parashtruesit kishte nxjerrë vendim për tërheqjen e aksioneve, vendim i cili më pas ishte pezulluar duke i dhënë parashtruesit edhe një afat prej 41 muajsh, për përmbushjen e zotimeve. Ky afat do të përfundonte në muajin tetor të vitit 2015.
17. Mirëpo, para skadimit të afatit të lartpërmendur, përkatësisht më 31 gusht 2014, Bordi i Drejtorëve të AKP-së (Vendimi Nr. BD-69/35), me arsyetimin se parashtruesi nuk kishte vepruar në përputhje të plotë me zotimet që ishin të përcaktuara në Marrëveshjen e zotimeve, mori vendim për ekzekutimin e Vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, të 16 dhjetorit 2011, për tërheqjen e aksioneve të Ndërmarrjes së Re MIM "Golesh" SHPK.

18. Të njëjtën ditë, Bordi i Drejtorëve të AKP-së (Vendimi Nr. BD-69/36) mori vendim për vënien e Ndërmarrjes së Re MIM “Golesh” SHPK nën administrimin e AKP-së.
19. Më 23 tetor 2014, Ushtruesi i detyrës së zëvendës drejtorit menaxhues të AKP-së, nxori vendim për zbatimin e dy vendimeve të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, të 31 gushtit 2014.
20. Më 30 tetor 2014, parashtruesi paraqiti në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS - së propozimin për nxjerrjen e urdhrit paraprak gjyqësor, përkatësisht pezullimin e përkohshëm të vendimeve të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, të 31 gushtit 2014.
21. Më 3 nëntor 2014, parashtruesi po ashtu parashtrroi padi në DHPGJS për anulimin e vendimeve të lartpërmendura të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, të 31 gushtit 2014. Bazuar në shkresat e lëndës, padia e parashtruesit është ende në shqyrtim e sipër në DHPGJS.
22. Më 19 nëntor 2014, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së (Aktvendimi, C-I-14-0022) refuzoi propozimin e parashtruesit për nxjerrjen e urdhrit paraprak gjyqësor si të pabazuar.
23. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së në Aktvendimin e tij vlerësoi se parashtruesi *“[...] nuk ka arritur të vërtetojë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme për të pezulluar veprimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së që parashtruesi e konteston përmes padisë së tij”*.
24. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së më tej konstatoi se, *“Bazuar në vlerësimin e pretendimeve të pakontestuar të paditësit dhe me qëllim të vendosjes së kërkesës për urdhër paraprak gjyqësor duke lënë të hapur çfarëdo vlerësimi në çështjen kryesore, gjykata vjen në përfundim se veprimi nga ana e AKP-së për të tërhequr aksionet e paditësit në ndërmarrjen “Golesh” duket të jetë e ligjshme, duke mos shkaktuar dëm fare, prandaj nuk ka nevojë të pezullohet fare”*.
25. Si rrjedhojë, Kolegji i Specializuar përfundoi se hyrja në fuqi e vendimeve të Bordit të Drejtorëve të AKP-së *“nuk shkaktonte ndonjë dëm që të ketë nevojë të kompensohet më vonë”*.
26. Më 25 nëntor 2014, kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së për refuzimin e nxjerrjes së urdhrit paraprak gjyqësor, parashtruesi ushtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS.
27. Në ankesën e tij, parashtruesi kërkoi që të anulohet Aktvendimi i Kolegjit të Specializuar dhe Kolegji i Apelit të konstatojë që vendimet e Bordit të Drejtorëve të AKP-së, të 31 gushtit 2014 janë *“janë antiligjore dhe janë marrë në kundërshtim me procedurat ligjore në fuqi”*. Parashtruesi më tej ka pretenduar se, vendimmarrja në Bordin e Drejtorëve të AKP-së nuk është zhvilluar sipas dispozitave ligjore në fuqi.

28. Më 5 shkurt 2015, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së (Aktvendimi, AC-I-14-0357-A0001) ankesën e parashtruesit e refuzoi si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar.
29. Në Aktvendimin e tij, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së vlerësoi se pretendimet ankimore të parashtruesit se vendimet e Bordit të Drejtorëve të AKP-së duhet të merren me shumicë të kualifikuar të votave, me më së paku 5 (pesë) anëtarë të Bordit, janë të pabazuara.
30. Kolegji i Apelit i DHPGJS më tej konstatoi se, vlerësimi i Kolegjit të Specializuar se *“blerësi nuk do të ketë ndonjë dëm”* është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi duke arsyetuar se një dëm financiar gjithmonë mund të kompensohet. Si rrjedhojë, Kolegji i Apelit përfundoi se:
- “Duke u bazuar në atë që u arsyetua më lart, Kolegji i Apelit konstaton se ankesa e paditësit është e pabazuar, dhe rrjedhimisht vërtetohet aktvendimi i Kolegjit të Specializuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.*
- Ky Aktvendim i Kolegjit të Apelit ka të bëjë vetëm me masën e përkohshme dhe nuk mund të ketë asnjë prejudikim për zgjidhjen përfundimtare të padisë”.*
31. Bazuar në shkresat e lëndës, del se padia e parashtruar nga parashtruesi është ende në procedurë të shqyrtimit pranë Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

32. Në kërkesën e tij, parashtruesi pretendon se me Aktvendimet e Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit], paragrafi 2, nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe të drejtat e tij të garantuara me nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ), dhe nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: DUDNJ).
33. Parashtruesi pretendon se Bordi i Drejtorëve të AKP-së, Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit të DHPGJS-së me aktvendimet e kontestuara kanë bërë shkelje të rëndë ligjore, për arsye se Vendimi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së për tërheqjen e aksioneve, i 31 gushtit 2014 është nxjerrë para skadimit të afatit për përmbushjen e zotimeve, afat që ishte zgjatur me vendim të Bordit të Drejtorëve deri në tetor të vitit 2015. Parashtruesi, ndër të tjera, më tej pohon se të gjitha veprimet e Bordit të Drejtorëve ndërlihen me faktin se *“AKM-AKP-ja nuk i kanë dhënë parashtrueses së kërkesës pëlqimin për lënien në hipotekë të paluejtshmërisë për sigurimin e investimeve kapitale, që nënkupton se e drejta e fituar përmes privatizimit ishte kufizuar nga AKM-AKP-ja [...]”*.
34. Lidhur me pretendimin e parashtruesit për shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, parashtruesi pohon se palët në procedurë, nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë. Parashtruesi shton më tej se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së ka konstatuar se, vendimmarrja në këtë rast duhet të zhvillohet me shumicë të

kualifikuar, dhe se në rastin konkret, njëri vendim është marrë me katër vota për dhe me një abstenim, ndërsa vendimi tjetër është marrë më pesë vota pozitive.

35. Në këtë drejtim, parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën që t'i shfuqizojë aktvendimet e kontestuara të Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së dhe *“rasti të rigjykohet sa i përket masës së sigurisë në atë mënyrë që ankuesi [parashtruesi] të kthehet ne asetet e blera te cilat i janë marrë nen kontroll nga AKP [...]”*.
36. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme, përkatësisht të pezullojë ekzekutimin e Vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, të 31 gushtit 2014, si dhe të Aktvendimeve të Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS, deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar nga DHPGJS.

Pranueshmëria e kërkesës

37. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
38. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës që parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Pretendimet e parashtruesit lidhur me vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së

39. Ashtu siç u përmend më lart, parashtruesi pohon se Vendimi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së për tërheqjen e aksioneve, i 31 gushtit 2014 është nxjerrë para skadimit të afatit për përmbushjen e zotimeve, dhe se vendimmarrja në Bordin e Drejtorëve të AKP-së është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të AKP-së.
40. Gjykata vëren se, parashtruesi i kërkesës pas parashtrimit të propozimit për nxjerrjen e urdhrit paraprak gjyqësor, po ashtu ka parashtruar padi në DHPGJS për anulimin e Vendimeve të lartpërmendura të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, të 31 gushtit 2014. Padia e parashtruesit është ende në shqyrtim e sipër pranë Kolegjit të Specializuar të DHPGJS.
41. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 47.2 të Ligjit, i cili parasheh: *“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*.
42. Në këtë rast, Gjykata po ashtu merr parasysh rregullin 36 (1), (b) të Rregullores së punës:

(1) "Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar.

[...]

43. Duke marrë për bazë faktin, që padia e parashtruesit është akoma në shqyrtim e sipër pranë DHPGJS-së, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës pretendimet e tij lidhur me mënyrën e vendimmarjes nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së mund t'i adresojë edhe gjatë procedurës së shqyrtimit të padisë së tij në DHPGJS. Bazuar në këtë, Gjykata vlerëson se këto pretendime janë të parakohshme, për arsye se duhet dhënë mundësia gjykatave të rregullta, përkatësisht DHPGJS-së për të përfunduar procedurat lidhur me padinë e parashtruesit që janë në vazhdim e sipër.
44. Qëllimi i rregullimit të shterimit të mjeteve juridike, është që në këtë rast t'u ofrohet gjykatave të rregullta mundësia e rregullimit të shkeljeve të pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se, rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete juridike kundër shkeljeve të të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës. (Shih rastin 41/09, parashtrues: *AAB – RIINVEST L.L.C.*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmëri i 21 janarit 2010, dhe shih, *Selmouni kundër Francës*, Nr. 25 803/94, GJEDNJ, Aktvendim i 28 korrikut 1999).
45. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, administrative ose gjyqësore, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka, të rregullohet shkelja e tillë e të drejtave themelore (Shih rastin K107/09, parashtrues: *Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri i 19 majit 2010).
46. Rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të vlerësojë shkeljet e pretenduara kushtetuese, pa iu dhënë mundësia gjykatave të rregullta, përkatësisht DHPGJS-së për të përfunduar procedurat lidhur me padinë e parashtruesit që janë në vazhdim e sipër dhe për t'i korrigjuar shkeljet e pretenduara.
47. Prandaj, Gjykata përfundon që pretendimet e parashtruesit lidhur me përmbajtjen dhe mënyrën e vendimmarjes së Bordit të Drejtorëve të AKP-së janë të parakohshme.

Pretendimet lidhur me Aktvendimet e DHPGJS për refuzimin e propozimit për urdhër paraprak gjyqësor

48. Ashtu siç u përmend më lart, parashtruesi i kërkesës konteston aktvendimet e Kolegjit të Specializuar dhe të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së përkitazi me propozimin e tij për urdhër paraprak gjyqësor, duke pretenduar se i janë shkelur të drejtat e tij me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit], paragrafi 2, nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm],

nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe të drejtat e tij të garantuara me nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së) dhe nenin 10 të DUDNJ.

49. Lidhur me këtë, Gjykata merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

50. Gjykata i referohet edhe rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

51. Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i DHPGJS në aktvendimin e tij konstatoi që vlerësimi i Kolegjit të Specializuar se parashtruesi nuk do të ketë ndonjë dëm, është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, duke arsyetuar se një dëm financiar gjithmonë mund të kompensohet. Kolegji i Apelit, pa paragjykim ndaj vendimit lidhur me padinë e parashtruesit pranë DHPGJS-së përfundoi se ankesa e parashtruesit përkitazi me propozimin e tij për urdhër paraprak gjyqësor është e pabazuar, duke vërtetuar aktvendimin e Kolegjit të Specializuar si të drejtë dhe të bazuar në ligj.
52. Gjykata konsideron se fakti i thjeshtë që parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta, nuk është i mjaftueshëm që parashtruesi i kërkesës të ndërtojë një pretendim për shkelje kushtetuese (Shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezótúr-Tiszazugi Vízgazdálkodási Társulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21). Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës (Shih rastin *KI198/13*, parashtrues i kërkesës: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 marsit 2014).
53. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç, dhe për aq, sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund ta zëvendësojë rolin e gjykatave të rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin *KI70/11*, parashtrues të kërkesës: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

54. Për më tepër, siç u përmend më lart, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së për refuzimin e nxjerrjes së urdhrit paraprak gjyqësor është i qartë dhe, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata ka gjetur se procedurat e përfunduara në Kolegjin e Specializuar dhe Kolegjin e Apelit të DHPGJS sa i përket urdhrit paraprak gjyqësor nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituaniës*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009).
55. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.
56. Prandaj, kërkesa e parashtruesit lidhur me pretendimet e tij përkitazi me refuzimin e propozimit të parashtruesit për urdhër paraprak gjyqësor janë qartazi të pabazuara.
57. Si përfundim, bazuar në arsyetimet e lartpërmendura Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit:
 - A. Në pjesën e kërkesës së parashtruesit përkitazi me pretendimet e tij lidhur me përmbajtjen dhe mënyrën e vendimmarrjes së Bordit të Drejtorëve të AKP-së është e papranueshme si e parakohshme.
 - B. Ndërsa pjesa e kërkesës së parashtruesit lidhur me pretendimet e tij, përkitazi me refuzimin e propozimit të parashtruesit për urdhër paraprak gjyqësor është e papranueshme si qartazi e pabazuar, sepse ai nuk i ka arsyetuar pretendimet e tij për shkelje të parimit të barazisë, mbrojtjes së pronës dhe të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç referohen nga parashtruesi i kërkesës.

Kërkesa për Masë të përkohshme

58. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme, gjegjësisht të pezullojë ekzekutimin e Vendimeve të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, të 31 gushtit 2014 dhe Aktvendimeve të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS (Aktvendim, C-I-14-0022, i 19 nëntorit 2014) përkitazi me refuzimin e propozimit të parashtruesit për urdhër paraprak gjyqësor dhe atij të Kolegjit të Apelit (Aktvendim, AC-I-14-0357-A0001, i 5 shkurtit 2015).
59. Parashtruesi pohon se vendosja e Masës së përkohshme është e nevojshme: *"[...] ngase është pamundësua disponimi me mjetet dha makineri e investuara me miliona, janë larguar qindra punëtor nga puna, është dëmtuar pervec interesat te investitorit të jashtem investimi i të cilit garantohet me ligjin për investimet e huaja në Kosove, ankuesi konsideron se është dëmtuar dhe dëmtohet edhe interesi publik me largim masiv të punetore nga puna për të cilët ankuesi ka investuar edhe në kualifikimet specifike të tyre pervec pagesave të pagave, dhe kemi edhe dëmtim të aseteve pasurisë e cila ka mbet pa mbikëqyrje dhe kujdes"*.
60. Përveç kësaj, në mënyrë që Gjykata të vendosë Masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, duhet të gjejë që:

“(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

“(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme...”.

61. Siç u konstatua më lart, kërkesa është e papranueshme për arsye se pretendimet e parashtruesit përkitazi me mënyrën e vendimmarrjes nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së janë të parakohshme, përderisa pretendimet e tij lidhur me Aktvendimet e Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit përkitazi me nxjerrjen e urdhrin paraprak gjyqësor janë qartazi të pabazuara.
62. Për më tepër, Gjykata rithekson se kërkesa për vendosjen e Masës së përkohshme duhet argumentuar mbi baza reale të shkaktimit të rrezikut apo të dëmit të pariparueshëm, vlera e të cilit është e pakompensueshme në kuptimin material dhe në të holla (Shih rastin KI187/13, parashtruese N. Jovanović, Gjykata Kushtetuese, Aktgjykim i 16 prillit 2014, paragrafi 74).
63. Prandaj, kërkesa e parashtruesit për vendosjen e Masës së parakohshme duhet të refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 27, 47.2 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1), (b) dhe (d), 36 (2) (b) dhe (d), 55 (4), si dhe 56 (2) dhe (3) të Rregullores së punës, më 31 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi